



Breaking News:

Durrës/Lirohen hapësira të tjera në plazhin e Shkëmbit të Kavajës që ishin zënë në mënyrë të paligjshme

II ◀▶



08/07/2025

Ksamil/Ënfinalizohet Operacioni Policor i Koduar "Impact"

Ksamil, Sarandë

Finalizohet nga Komisariati i Policisë Sarandë, operacioni policor i koduar "Impact", për goditjen e veprimtarisë kriminale të armëmbajtjes pa leje.

Qarkullonte me armë zjarri pistoletë me municion luftarak, në automjet, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 31-vjeçari.

Sekuestrohen arma e zjarrit, krehri i saj me fishekë dhe automjeti tip "Range Rover".

Në vijim të kontrolleve të shtuara për garantimin e rendit dhe sigurisë publike gjatë sezonit turistik, dhe bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative, lidhur me një rast të armëmbajtjes pa leje që cenonte sigurinë e qytetarëve, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Sarandë organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Impact". Si rezultat, u arrestua në flagrancë shtetasi kosovar:

Sh. M., 31 vjeç, banues në Gjiilan, Kosovë.

Gjatë kontrollit në automjetin tip "Range Rover" që drejtonte ky shtetas, në Ksamil, shërbimet e Policisë gjetën të fshehur në çantën e tij të dorës, 1 armë zjarri pistoletë tip "Beretta", me një krehër me fishekë.

Arma, municioni dhe automjeti i 31-vjeçarit u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për veprime të mëtejshme.

#angazhimpërkushtimsakrificë
#tëvendosurkundërkrimit
#nëçdoskajtëvendit
#nëshërbimtëqytetarëve

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

▼

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Raporti i ngjarjeve, 8 korrik 2025

Policia e Shtetit, ftesë për maturantët që të aplikojnë për studimet "Bachelor" në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë ▶